



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201900457/7

Tiranë _16_/4_/2020

Lënda : *Rekomandim për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, që ka pësuar dhunë ose ka qenë i pranishëm kur është ushtruar dhunë*

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

ZONJËS GELARDINA PRODANI

TIRANË

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur një ankesë nga zonja Dh. A., banorë në Njësinë Administrative Portëz, Bashkia Fier, për mospërfshirjen e djalit të saj, me inicialet A.A, në skemën e Ndihmës Ekonomike, si viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare, në zbatim të pikave "I", "ii", "iii" dhe "iv" të vendimit nr.62-2018-4820 (184), datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Institucioni I Avokati të Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, lidhur me problematikën e ngritur nga shtëpsja në fjalë.

Të gjitha veprimet e ndërmarra nga institucioni I Avokatit të Popullit janë në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, për të garantuar mirëqenien e fëmijës me inicialet A.A. në rastin konkret edhe të zbatimit të

vendimit nr.62-2018-4820(184), datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Më lejoni, që në mënyrë të përmbledhur të prezantoj rastin, për të cilin institucioni i Avokatit të Popullit kreu hetimin administrative, nëpërmjet komunikimit shkresor.

Nisur nga fenomeni shqetësues i dhunës së ushtruar në marrëdhëniet familjare në shoqërinë tonë, si një nga llojet më të përhapura të dhunës së përjetuar nga gratë dhe fëmijët, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, duke kërkuar shpjegime nga institucionet përgjegjëse të administratës shtetërore, konkretisht: Njesisë Administrative Portëz dhe për dijeni, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier.

Në përfundim të procesit hetimor administrative, të kryer nga institucioni I Avokatit të Popullit, në vlerësim të informacionit të gjeneruar, për rastin në fjalë rezulton se:

- Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier, nuk ka përfshirë të miturin A.A., në skemën e Ndhmës Ekonomike¹, pasi në vendimin nr.62-2018-4820(184), datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lëshimi i urdhërit të mbrojtjes është vetëm për paditësen Dh.A..
- Drejtorja rajonale Fier, në përgjigjen zyrtare² informon, se nga vlerësimi i sistemit elektronik të ndihmës Ekonomike znj. Dh.A., z.A. A.dhe djali i tyre me inicialet A.A., janë përfitues në skemën e Ndhmës Ekonomike si familje në nevojë, në masën e përfitimit 2700 (dymijë e shtatëqind) lekë.

Për sa më sipër, struktura e familjes Agaraj përbëhet nga z. Astrit Agaraj, znj. Dh.A. dhe fëmija I tyre me inicialet A.A., të cilët trajtohen si familje në skemën e Ndhmës Ekonomike, në masën e përfitimit 2700 (dymijë e shtatëqind) lekë³. Nisur nga masa e përfitimit të Ndhmës Ekonomike, 2700 (dymijë e shtatëqind) lekë, përllogaritja⁴ e kryer përfshinë 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë për zotin Agaraj dhe 900 (nëntëqind) lekë për fëmijën me inicialet A.A. Pra, nuk është përllogaritur masa e përfitimit për znj. Dh.A., pasi është përfituese e

¹ Shkresa zyrtare me nr.318/1 prot, datë 23.4.2019, kthim përgjigje për ankesën e shtetasës Dhurata Agaraj;

² Shkresa zyrtare me nr.171/1, datë 23.4.2019;

³ Në mbështetje të vendimit nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe të Përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike”;

⁴ Në zbatim të udhëzimit nr.4, datë 17.2.2017 të miistrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për përllogaritjen e Përfitimit të Ndhmës Ekonomike”.

skemës së ndihmës Ekonomike, si viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare, në përputhje edhe me vendimin nr.62-2018-4820(184), datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në pikën 2, të vendimit nr. nr.62-2018-4820(184), datë 1.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lëshimi i urdhërit të mbrojtjes për paditësen Dh.A. konsiston në marrjen e masave⁵, të cilat janë në funksion të mbrojtjes të shtetasës Dh.A. dhe fëmijës me inicialet A.A., nga shtetasi Astrit Agaraj, I cili urdhërohet të mos çënojë, ngacmojë, kontaktojë apo komunikojë drejtpërdrejt apo tërthorazi me viktimën Dh.A. dhe fëmijën e tyre A.A., madje, duke e ndalur që t'i afrohet banesës së tyre, në një distancë prej 100 metrash.

Për sa më sipër, gjykata nuk ka vendosur lëshim të urdhërit të mbrojtjes në mënyrë të drejtpërdrejtë për fëmijën A.A., por e ka përfshirë atë në të gjitha masat mbrojtëse, si edhe viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare, shtetasen Dh.A..

Në vlerësim të veprimeve të kryera nga Njësia Administrative Portëz, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe vendimit të gjykatës, znj. Dh.A. është përfitues e skemës së Ndihmës Ekonomike⁶. Gjithahstu, edhe fëmija me inicialet A.A., është përfitues i skemës së Ndihmës Ekonomike, në masën e Ndihmës Ekonomike prej 900 (nëntëmijë) lekë, si antarë i strukturës së familjes Agaraj. Por përfitimi e kësaj vlere monetare administrohet nga shtetasi Astrit Agaraj, të cilin gjykata e ka udhëruar të mos, çënojë, ngacmojë, kontaktojë apo komunikojë drejtpërdrejt apo tërthorazi me viktimën Dh.A. dhe fëmijën e tyre me inicialet A.A., duke ndalur që t'i afrohet banesës së tyre në një distancë prej 100 metrash.

Në këtë kuptim, pavarësisht zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi dhe vendimit të gjykatës nga ana e organeve të administratës shtetërore konstatojmë mungesën e harmonizimit të kuadrit ligjor të sipërcituar me vendimin e gjykatës, pasi të ardhurat në vlerë monetare, të përfitura nga skema e Ndihmës Ekonomike të fëmijës me inicialet A.A., nuk menaxhohen dhe administrohen nga nëna e tij, e cila është urdhëruar me vendim gjykate të kujdest për të. Por, në të njëjtën kohë, kjo problematikë e krijuar, mund të jetë nxitëse për vazhdimësinë e dhunës dhe shkatërrimin e familjes, pasi një ndër faktorët e ushtrimit të dhunës në këtë familje është pikërisht, varfëria dhe kushtet e vështira social-ekonomike, në të cilën jeton ajo.

⁵ Në zbatim të pikës, 3/1 të nenit 10, të ligjit nr. ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, është përcaktuar se gjykata, në urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhërin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm;

⁶ Në zbatim të shkronjës “d”, të neit 7, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Për rrjedhojë, në kushtet e varfërisë ekstreme familja nuk mund të kryej funksionin primar, kujdesin për mirëritje, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijës.

Në këtë kuptim, në funksion të harmonizimit të kujadrit të ri ligjor të miratuar, për mbrojtjen e fëmijës dhe dhunës në marrëdhëniet familjare, drejt një qasje të bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, në interesin më të lartë të fëmijës, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të neneve 21 dhe 24, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar,

R E K O M A N D O N:

- Marrjen e masave për një ndryshim legjislativ në shkronjën "d" të nenit 7, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", për përfshirjen e fëmijës që ka pësuar dhunë ose ka qenë i pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje, përfshirë në masat mbrojtëse të Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose/dhe në Urdhërin e Mbrojtjes, si përfitues i drejtëpërdrejt i skemës së Ndhmës Ekonomike.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për miëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

Duke Ju falënderuar,

K O M I S I O N E R

Nejla PEKA

Konceptoi: M.Tyli